

MENDIM PARALEL

Unë Firdes Shuli, në cilësinë e relatores së çështjes, kam ndarë opinion të ndryshëm nga dy anëtarët e trupës, në lidhje me pozitën e znj. Brunilda Çarçiu në procesin e rivlerësimit, duke qenë e mendimit që nuk është subjekt rivlerësimi, në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, kam votuar kundër qenies së saj subjekt rivlerësimi, sipas arsyesimit të mëposhtëm.

1. Znj. Brunilda Çarçiu, pas diplomimit në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike në datën 5.7.1991, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh dhe e ka ushtruar këtë funksion deri në vitin 2000. Nga viti 2000 deri në vitin 2011 ka ushtruar funksionin e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë. Në datën 4.1.2012 është emëruar specialiste në Departamentin Juridik të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 18.11.2016, kur është emëruar inspektore nga KLGJ-ja. Ndërsa, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2019, KLGJ-ja i ka njohur asaj statusin e magjistratit.

2. Neni 179/b, pika 3 dhe 4, e Kushtetutës parashikon se: *“3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. 4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet”.*

3. Referuar kësaj dispozite ligjore, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese¹, në gusht të vitit 2016, znj. Brunilda Çarçiu ka qenë specialiste në Drejtorinë Juridike, pranë ish-KLD-së, me status të nëpunësit civil dhe, si e tillë, nuk e ka marrë cilësinë e subjektit të rivlerësimit *ex officio*, siç do ta merrte nëse do të kishte qenë inspektore pranë KLD-së. Në këto kushte, e vetmja mënyrë për t’iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit do të ishte me kërkesë, sipas përcaktimeve të pikës 4 të dispozitës më sipër dhe nëse do të përmbushte disa kriteret të rregulluara nga ligji si ish-gjyqtare ose ish-këshilltare ligjore e Gjykatës së Lartë.

4. Konkretisht, për këtë kategori, ligji nr. 84/2016, në nenet 31, 35 dhe 41, ka parashikuar paraqitjen me shkrim pranë Komisionit të kërkesës për rivlerësimin e tyre brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, e cila i bashkëlidhet formularit përkatës, detyrim i cili nuk rezultoi të jetë përmbushur brenda këtij afati nga znj. Brunilda Çarçiu. Në lidhje me mungesën e kërkesës për rivlerësim të znj. Brunilda Çarçiu, shumica e ka pranuar këtë fakt, por arsyeton se *... mosformalizimi i një kërkesë të tillë, e cila nga legjislatori është parashikuar si “një e drejtë” e çdo subjekti që plotëson kriteret e nenit 179/b, pika 4, fjalitë e 2-të, duhet të çmohet nën rrethanat faktike e ligjore: (i) mbi disponimin e vendimit të KLGJ-së “Për deklarimin e pasjes së statusit”, për znj. Brunilda Çarçiu; si dhe (ii) në ndërmarrjen e veprimeve dhe shprehjen e vullnetit të saj¹ që dëshmojnë fakte se znj. Brunilda Çarçiu është sjellë në mënyrë konsistente si subjekt rivlerësimi. Në këtë drejtim vlen të përmendet fakti se nëse do të analizonim shkakun e mosparaqitjes së kërkesës në kohë për rivlerësimin e saj si një ish-gjyqtare, duket qartë që*

¹Ligji nr. 76/2016, ka hyrë në fuqi në datën 11.8.2016 (15 ditë nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare nr. ***, datë 27.7.2015).

kjo ka ndodhur vetëm për shkak të interpretimit dhe vlerësimit të ndryshëm (paraqitur vetëm pas dërgimit të rezultateve të hetimit) të pozicionit të saj si subjekt ex officio dhe aspak për mospasje vullneti për t'u vetuar.

5. Përkundër sa arsyeton shumica, vlerësoj se vendimi i KLGJ-ja, si dhe ndërmarrja e veprimeve të subjektit, nuk mund të zëvendësojnë kërkesën (apo të justifikojnë mungesën e saj), që znj. Brunilda Çarçiu duhet të bënte brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, sipas dispozitave të sipërmendura. Vetëm në muajin prill të vitit 2018, znj. Brunilda Çarçiu ka ngritur përpara Komisionit pretendimin se i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtare. Në këto kushte, znj. Brunilda Çarçiu nuk e ka marrë cilësinë e subjektit të rivlerësimit me kërkesë, si ish-gjyqtare.

6. Ka pasur mendim të ndryshëm të dy anëtarëve të trupës lidhur me momentin fillestar, nga ku përcaktohet mbajtja e cilësisë së subjektit të rivlerësimit, sipas të cilëve, momenti përcaktues nuk është hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese (gusht 2016), por momenti që Gjykata Kushtetuese ka vendosur mbi kushtetutshmërinë e disa dispozitave të ligjit të rivlerësimit kalimtar (janar 2017). Në vlerësimin tim, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit², momenti që një subjekt duhet të kategorizohet si subjekt rivlerësimi është qenia e tij në një nga funksionet e parashikuara në nenin 179/b të Kushtetutës, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe jo në momentin që Gjykata Kushtetuese është shprehur mbi ligjin nr. 84/2016, apo qoftë edhe momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji përpara se të pezullohej. Kjo pasi, është Kushtetuta ajo që ka përcaktuar kuptimin dhe kategoritë e subjekteve të rivlerësimit, ndërkohë që në ligjin nr. 84/2016 është përcaktuar procedura e detajuar e procesit të rivlerësimit për secilën kategori.

7. Një tjetër çështje për të cilën ndaj mendim të ndryshëm, lidhet me argumentin e shumicës se vullneti i treguar nga znj. Brunilda Çarçiu për t'u rivlerësuar, si dhe hapat konkretë që ka ndërmarrë me dorëzimin e formularëve dhe dokumenteve përkatëse brenda institucioneve përkatëse në janar të vitit 2017, kur ishte në pozicionin e inspektore, nuk mund ta shmangin atë nga procesi i rivlerësimit. Në opinionin tim, e ndërlidhur kjo me arsyetimin e mësipërm mbi momentin e cilësimit të saj si subjekt rivlerësimi, vullneti për t'iu nënshtuar procesit të rivlerësimit, pa përmbushur kushtet e tjera ligjore që lidhen detyrimisht me pasjen e një funksioni të caktuar, është i pamjaftueshëm për ta kualifikuar atë si subjekt rivlerësimi.

8. Në arsyetimin e saj shumica është shprehur se: *“Për të kualifikuar znj. Brunilda Çarçiu subjekt rivlerësimi, sipas përkufizimit kushtetues, vlerësohet se kuadri ligjor i sipërcituar duhet*

²Në vendimin nr. 5, datë 12.2.2021, të Kolegjit, pika 36.2, parashikohet se: *“Në kushtet kur ndryshimet kushtetuese që normuan rivlerësimin e gjetën subjektin e rivlerësimit në një nga detyrat e përmendura nominalisht nga pika 3 e kësaj dispozite, ajo ishte subjekt rivlerësimi ex officio. Ky fakt qëndron, është i pakontestueshëm dhe autonom nga momenti kur statusi i magjistratit deklarohet i mbaruar nga institucionet përkatëse”.*

Në vendimin nr. 5, datë 12.2.2021, të Kolegjit, pika 36.3, parashikohet se: *“Qartazi, në momentin kur u miratuan dhe hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese që përfshinë edhe këtë dispozitë – korrik dhe gusht 2016 respektivisht – subjekti i rivlerësimit, znj. E. Q., ishte gjyqtare. Nëse do të pranohej argumenti i saj, nga procesi i rivlerësimit do të përjashtoheshin me sukses të gjithë subjektet që nuk ishin në detyrë në momentin kur u vinte radha të shortoheshin apo çështja e tyre të shqyrtohej nga Komisioni, gjatë gjithë harkut kohor prej 5 vjetësh që përbën mandatin e këtij të fundit, megjithëse e gëzonin këtë cilësi me hyrjen në fuqi të ligjit.”*

Në vendimin nr. 2, datë 13.1.2021, të Kolegjit, pika 10, parashikohet se: *“Në këto kushte, në kuptim të kësaj dispozite, si edhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se subjekt rivlerësimi janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka fituar këtë status ligjor që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese e, për pasojë, do të duhej t'i nënshtrohej ex officio procesit të rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon këtë proces”.*

lexuar/analizuar dhe, për rrjedhojë, duhet çmuar në situatën faktike dhe ligjore që gjendet znj. Brunilda Çarçiu” dhe, më tej, arsyeton se: “Nga një analizë harmonike dhe objektive të rrethanave dhe fakteve, me një vlerësim konkret/pragmatik në aspektin substancial dhe jo strict formal, u vlerësua më e përshtatshme zgjedhja e vijimit të procesit të rivlerësimit për znj. Brunilda Çarçiu, për sa kohë vendimi i KLGJ-së, për njohjen e statusit të magjistratit për znj. Brunilda Çarçiu, i shtrin efektet në një periudhë të mëhershme, pikërisht, në sajë të funksioneve të mbuluara në karrierën e saj, duke e barazuar plotësisht me subjektet e tjera përpara mbarimit të afatit për paraqitjen e formularëve, pikërisht, për të mundësuar nisjen e procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, Komisioni vlerëson që nga një këndvështrim më i gjerë, duke pasur parasysh frymën e dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, që synojnë rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve, inspektorëve, ndihmësve ligjorë – dhe jo vetëm – duke përfshirë këtu edhe ata të cilët kanë pasur më herët një të kaluar profesionale si gjyqtarë, prokurorë apo këshilltarë ligjorë (ish...) dhe aspirojnë të rikthehen si aktorë në sistemin e drejtësisë, ndonëse ndërkohë e kanë humbur statusin e mëparshëm, përforcohet bindja se znj. Brunilda Çarçiu duhet të përfshihet ndër subjektet që duhet t’i nënshtrohen hetimit administrativ për rivlerësimin kalimtar. Në të kundërt nuk mund të konsiderohet në harmoni dhe në përputhje me këto dispozita dhe as në funksion të realizimit të qëllimit të reformës në drejtësi, moskryerja e procesit të rivlerësimit ndaj një ish-gjyqtari që, më pas, ka mbuluar funksione të ndryshme në karrierë. Kësisoj, alternativa e anashkalimit/mos kryerjes të procesit të rivlerësimit, duke ndërprerë këtë proces me një vendim jo përfundimtar, jo vetëm që do të binte ndesh me frymën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore në fjalë, por do të rezultonte totalisht e pambështetur në ligj dhe në prova, si dhe me mangësi të argumenteve analitiko-juridike bindëse”.

9. Siç vërehet, shumica në vlerësimin e çështjes në lidhje me kualifikimin e znj. Brunilda Çarçiu si subjekt rivlerësimi, arsyeton se kuadri ligjor të cilit i referohet, duhet lexuar/analizuar dhe, për rrjedhojë, duhet çmuar, në situatën faktike që gjendet znj. Brunilda Çarçiu, me një vlerësim pragmatik dhe jo strict formal, duke iu referuar midis të tjerash: (i) shprehjes së vullnetit të subjektit, si dhe sjelljeve të saj, në raport me detyrimet ligjore, si para ashtu dhe përgjatë hetimit administrativ dhe deri aktualisht; (ii) faktit që ka qenë një ish-gjyqtare; (iii) qenies në detyrën e inspektores në kohën kur ligji filloi efektet e zbatimit të tij; (iv) vendimit nr. ***, datë 13.12.2019, të KLGJ-së, që deklaroi pasjen e statusit “magjistrat”.

10. Përkundër këtij qëndrimi, unë si anëtare në pakicë, mendoj se shumica ka anashkaluar vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore të vendosura në Kushtetutë për ta kualifikuar znj. Brunilda Çarçiu si subjekt rivlerësimi dhe, për rrjedhojë, ndaj qëndrimin që në rastin konkret bëhet i domosdoshëm një vlerësim në kuptimin *strict formal* të ligjit, pasi një interpretim më i gjerë, sikurse është bërë nga ana e shumicës, zgjeron kategorinë e subjekteve që do t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe në këndvështrimin tim, tejkalon parashikimet kushtetuese mbi rivlerësimin kalimtar.

11. Në përfundim, në cilësinë e relatores, duke vlerësuar që znj. Brunilda Çarçiu nuk e ka pasur cilësinë e subjektit të rivlerësimit, mendoj se ndaj saj nuk mund të kryhej procesi i rivlerësimit, për shkak të mungesës së objektit të kësaj procedure administrative dhe, për këtë arsye, kam propozuar dhe votuar për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të saj pa një vendim përfundimtar, sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.

12. Sa i takon ndalimit të emërimit në detyra brenda sistemit të drejtësisë të subjekteve që japin dorëheqjen, për një periudhë 15-vjeçare, shumica arsyeton se: “...nëse do të ndërpritej procesi i rivlerësimit, përjashtimi i subjektit nga sistemi i drejtësisë për 15 vjet, si e vetmja rrugë që mund të ndërpriste këtë proces tashmë të nisur (së bashku me dorëheqjen), nuk do të ishte në përputhje me parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Midis mosveprimit (në kohë), pa pasoja administrative lidhur me procesin e rivlerësimit (që ka nisur pas paraqitjes së deklaratës nga znj. Brunilda Çarçiu), si dhe masës penalizuese, të përjashtimit nga sistemi për 15 vjet, Komisioni vlerësoi se zgjidhja më e përshtatshme dhe në përputhje me vullnetin e shprehur nga subjekti, me frymën e ligjit dhe me interesin publik, do të ishte kryerja e rivlerësimit për këtë subjekt”.

13. Siç vërehet, edhe në këtë rast, në vlerësimin e saj shumica i referohet një zgjidhjeje më të përshtatshme në përputhje me vullnetin e shprehur nga subjekti dhe nën frymën e ligjit. Edhe në këtë pikë, në ndryshim nga anëtarët e trupit gjykues, jam e mendimit që kjo ndërprerje nuk duhet të shoqërohet me masën e largimit për 15 vjet nga sistemi i drejtësisë, sipas nenit G, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës, pasi për një vendimmarrje të tillë do të ishte më parë i nevojshëm kualifikimi i subjektit si subjekt rivlerësimi, sipas kriterëve kushtetuese. Nga ana tjetër, neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, i jep të drejtë organit publik të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

14. Bazuar në sa më sipër, pas vendimmarrjes me shumicë votash, në lidhje me statusin e znj. Brunilda Çarçiu, kam vijuar me ushtrimin e detyrave që ligji nr. 84/2016, më ka ngarkuar në cilësinë e relatores së çështjes, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 14 të këtij ligji dhe në përfundim të procedurave të rivlerësimit për të tria kriteret, kam propozuar shkarkimin nga detyra bazuar në vlerësimin përfundimtar të provave dhe rrethanave në lidhje me kriterin pasuror në gjendjen faktike të tyre, pas dërgimit të parashtrimeve nga ana e subjektit Brunilda Çarçiu, duke vijuar me arsyetimin e vendimit.

15. Duke qenë se në vlerësimin tim, znj. Brunilda Çarçiu nuk ka qenë asnjë prej subjekteve të rivlerësimit të përmendura nominalisht në nenin 179/b të Kushtetutës, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, rivlerësimi i saj, sipas kriterëve të ligjit nr. 84/2016, duke u barazuar me subjektet e tjerë e ka rënduar pozitën e saj, duke çuar në shkarkimin e saj nga detyra, çka sjell si pasojë ndërprerjen për 15 vjet të ushtrimit të detyrës në organet e drejtësisë, pasojë e cila nuk do të vinte nëpërmjet ndërprerjes së procesit pa një vendim përfundimtar, sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative.

KOMISIONERE

Firdes SHULI